

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SHËRBIM I LAVANDERISË DHE HOTELERISË PËR PACIENTËT E HOSPITALIZUAR NË PAVIONET E QENDRËS SPITALORE RAJONALE “SHEFOET NDROQI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shërbim lavanderie dhe pastrimi kimik – **98310000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 251,259,120.12 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh, ose 2,639,831.06 (dy milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e një pike zero gjashtë) Euro pa tvsh.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (95.18), datë 09.06.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 11 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, duke vlerësuar që plotësimi i kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 11 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike. Garancia mbi përvojën e ngjashme është e rëndësishme, duke mbajtur në konsideratë natyrën e objektit e prokurimit, që lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin e pacientëve në spital.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, qira ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient, ku shtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit lavanderisë objekt prokurimit. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është lavanderia, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë një ambient për kryerjen e këtij shërbimi dhe të gjitha proceseve të punës, që ky shërbim përfshin, si: larje, tharje, hekurosje, paketim. Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, i cili plotëson kushtet higjeno-sanitare, siguron AK që shërbimi i lavanderisë, objekt prokurimi, do të kryehet në kohë, cilësi dhe konform kushteve higjeno-sanitare.

Pajisja me aktin higjeno-sanitar e këtij ambjenti, është vendosur bazuar në Ligjin nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 139, datë 14.4.2011, “Për lëshimin e akt miratimit higjeno-sanitar”, Udhëzimin nr.510, datë 13.12.2011, “Për inspektimet higjeno-sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjeno-sanitar, si dhe duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka ruajtja dhe plotësimi i kushteve të higjenes, për këtë shërbim, i cili lidhet drejtëpërdrejt me shëndetin e pacientëve në spital.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë leje mjedisore të Tipit B “Pastrim kimik”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet, në fushën e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 5, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë lejen mjedisore që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Pajisja me këtë leje mjedisore, siguron AK që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore mjedisore, si dhe shërben si garanci që ekzekutimi i marrëveshjes kuadër, do të kryhet nga OE në përputhje me standartet e kërkuara ligjore dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë:

- **SSH EN 14065:2016** mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e kontrollit të Biokontaminimit. Nisur nga shërbimi objekt prokurimi, pajisja e operatorit ekonomik me këtë standart është një garanci shtesë që ofertuesi ushtron aktivitetin e tij, dhe kryen proceset e këtij shërbimi duke respektuar protokollet për mbrojtjen e shëndetit publik në ambiente me rrezik të lartë infeksioni si spitali, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë në fushën mjekësore. Ky standard përshkruan një qasje të menaxhimit të rrezikut, të quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit të biokontaminimit (RABC), i projektuar për të lejuar pastrimin e produkteve të vazhdueshme për të siguruar cilësinë mikrobiologjike të indeve të trajtuara në lavanderi, pra lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke siguruar kontrollin e rreptë të higjenës, i domosdoshëm për mjediset spitalore ku parandalimi i infeksioneve është kritik, rregullon procesin e larjes, sterilizimit dhe paketimit të tekstileve, duke garantuar që ato të jenë të sigurta për përdorim nga pacientët dhe personeli mjekësor.

3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 23 (njëzet e tre) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
1	Përgjegjës Shërbimi	2 (dy)
2	Punonjës në Lavanderi	10 (dhjetë)
3	Punonjës Shërbimi në pavione	9 (nëntë)
4	Shofer	2 (dy)
	Totali i punonjësve	23 (njëzet e tre)

a) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi/ duke përfshirë edhe kualifikime të tjera ekuivalente, dhe duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 1 (një) vit.

Për Përgjegjës të shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën e kërkuar.

b) Për punonjës të pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

c) Për punonjës të pikën 4 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse dhe leje drejtimi për mjetet e kërkuara.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë: Përgjegjësi i shërbimit ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Është vlerësuar e nevojshme që përgjegjësi i shërbimit të ketë një nga profesionet si: kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi, si profesione të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, pasi kanë njohuri të specializuara mbi proceset kimike dhe biologjike që përfshihen në larjen, dezinfektimin dhe sterilizimin e tekstileve spitalore, aftësi për të menaxhuar rreziqet biologjike dhe ndotjet, si dhe për të garantuar higjienizimin sipas protokollove shëndetësore. Kimisti siguron menaxhimin korrekt të kimikateve, garanton dozimin dhe përqendrimet e duhura për efektivitet maksimal, parandalon reaksione të rrezikshme kimike dhe dëmtimin e materialeve./Bioteknologu siguron efektivitetin e proceseve të dezinfektimit dhe sterilizimit, ndihmon në parandalimin e përhapjes së infeksioneve, vlerëson ndikimin biologjik të proceseve të lavanderisë./Inxhinieri i mjedisit ka njohuri të avancuara mbi trajtimin e ujrave të ndotura dhe kimikateve që përdoren gjatë procesit të larjes, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e legjislacionit përkatës, kontrollin e ndikimit mjedisor të aktivitetit objekt prokurimi, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve me ngarkesë biologjike apo kimike, si dhe është i aftë të organizojë dhe zbatojë sisteme për monitorimin e ndotjes dhe sigurisë, të domosdoshme për shërbime që veprojnë në kushte higjeno-sanitare të kontrolluara. Numri dy i përgjegjësit lidhet me nga njesinë: Tiranë dhe njesinë Kavajë.

Vitet e eksperiencës për përgjegjësin e shërbimit, janë vendosur duke mbajtur në konsideratë natyrën komplekse të shërbimit, objekt prokurimi, dhe proceseve të përfshira në lavanderinë profesionale: Menaxhimi i cikleve të larjes dhe dezinfektimit, kontrolli i procesve të tharjes dhe hekurosjes, standartizimi i paketimit dhe ruajtjes, organizim i dorëzimit dhe logjistikës, kontroll i vazhdueshëm i higjienës dhe dezinfektimit, si dhe ndërlydhjen e të gjitha proceseve (ku cdo proces kërkon aftësi të konsoliduara në menaxhimin e të gjithë zinxhirit, duke garantuar cilësi dhe siguri). Gjithashtu, eksperiencia e paktën 1 viti, siguron AK se përgjegjësi i shërbimit ka eksperiencë të mjaftueshme për të përballuar situata reale dhe aftësi praktike në zgjidhjen e tyre, për të ndërtuar protokolle funksionale dhe cilësi të qëndrueshme të realizimit të shërbimit, organizimin e stafit dhe zbatimin e të gjitha proceseve të shërbimit, në përputhje me kërkesat e mjedisit spitalor. Proceset e lavanderisë kërkojnë përvojë reale në menaxhimin e tyre dhe kjo eksperiencë e kërkuar siguron vazhdimësi dhe stabilitet në menaxhimin e të gjitha proceseve.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, ngarkim-shkarkim, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Punonjës shërbimi në reparte janë të nevojshëm për të kryer proceset e marrjes dhe ndarjes së materialeve nga spitali, zëvendësimin e materialeve të buta, shtrimin e tyre.

Shofer janë të nevojshëm për të kryer procesin e transportimit të materialeve nga spitali, dhe anasjelltas.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin/frekuencën e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhet të përmbushë ky shërbim, si dhe duke konsideruar se Qendra Spitalore Rajonale „Shefqet Ndroqi“ përbehet nga dy njesi: Tiranë dhe Kavajë.

Struktura dhe numri i nevojshëm i personelit për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi është vlerësuar të jetë e tillë nga grupi i punës i AK përfitues.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale
1	Makinë larëse profesionale min 40 kg	copë	3 (tre)
2	Makineri Barriera larese profesionale min 50 kg	copë	1 (nje) ose me kombinim pajisjesh,
3	Makinë larëse me disa dhoma larjeje min 100 kg		1 (nje) ose me kombinim pajisjesh,
4	Makinë tharëse profesionale (me kapacitet mbi 50 kg secila)	cope	3 (tre)
5	Makineri hekurosëse (rul) profesional	cope	2 (dy)
6	Makineri paketimi profesionale për paketim rrobash	Cope	1 (një)
7	Karroca të shpërndarjes së materialeve	Cope	7 (shtatë)
8	Makineri për larjen dhe dezinfektimin e karrocave	Cope	1 (një)
9	Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jetë kalibruar dhe të shoqërohet me akt kolaudimi të leshuar nga autoritetet perkatese (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)	Cope	2 (dy)

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavanderisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosje, ndarja- marrja e materialeve të buta sipas ndotjes dhe shtrimit të tyre. Nisur nga rëndësia e ruajtjes së higjienës për shërbimin e lavanderisë, vecanërisht në ambientet spitalore, janë vendosur gjithashtu edhe pompa dizinfektante në karrocet shërbimi në pavione, me qëllim përmbushjen e protokollove

të zbatueshme, parandalimin e transferimit të baktereve/viruseve nga një ngarkesë në tjetrën, si dhe materiali i butë i cili do të shpërndahet në pavione të mbetet i sigurtë për përdorim.

Duke qenë se njësia matëse e objektit të prokurimit, është kg, dhe OE do të ofertojnë për njësinë në kg, disponimi i peshores, lidhet drejtëpërdrejtë me ekzekutimin me sukses të kontratës.

Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe pesha) është vendosur nga Grupi i punës i AK përfitues, i cili nisur nga të dhënat e sasive të inventarit në përdorim dhe peshën për kg, referuar artikujve sipas specifikimeve teknike, ka përcaktuar sasinë e nevojshme të makinerive, pajisjeve që duhet të disponojë operatori ekonomik me qëllim ofrimin e shërbimit, objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme:

			QSRSHN	
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Skede teknike/katalog	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Çarçaf shtrati i poshtem			
2	Çarçaf shtrati i siperm			
3	Carçafi zarf			
4	Kellef dysheku			
5	Jastëk			
6	Këllëf jastëku			
7	Jorgane I lehtë vatine (njëngjyrësh)			
8	Robdishan pacienti Adult			
9	Robdishan pacienti pediatrik			
10	Komplete pizhame pacienti adult			
11	Komplete pizhame pacienti pediatrik			
12	Pandofla pacienti adult			
13	Pandofla pacienti			
14	Pandofla personeli			

15	Pandofla personeli (për salat e operacionit)			
16	Peshqire (pacienti, personeli, urgjence, kabinetit)			
17	Kompresa			
18	Dyshek spitalor			
19	Përparëse mjeku unisex			
20	Kostume infermieri			
21	Kostume sanitare			
22	Bluzë me mëngë të gjata me zinxhir			
23	Kostume personeli ndihmës			

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit, objekt prokurimi, dhe detyrimet e ofertuesit i cili do të shpallet fitues për të siguruar inventarin e materialit të butë, për një kompletim të rregullt sipas normave të shtratis që ka QSRSHN, me emërtimin dhe logon përkatëse të QSRSHN, kriteri i mësipërm garanton AK për realizimin e kontratës/ava, konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara. Ky kriter gjithashtu përbën një angazhim të ofertuesit se materiali i butë përmbush specifikimet teknike dhe mbështet procesin e verifikimit të mëvonshëm, pas lidhjes së kontratës, ku operatori ekonomik fitues ka detyrimin të dorëzojë materialet e buta me certifikate analize, në përputhje me standartet STASH në fuqi dhe standarteve europiane CE, si dhe paraqitjen e mostrave për cdo artikull.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalore” sipas klasifikimit në Termat e References shtojca 10 e DST:

- Material i kontaminuar”
- Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.
- Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”
- Material i pisët”

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.

- II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta “me ndotje spitalor”
- III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Materialet e pastrimit				QSRSHN
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjines së produktit të pastrimit	Lloji/Emertimi I detergjentit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Material i kontaminuar			
2	Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare			
3	Material i konsideruar “me rrezik mikrobiologjik”			
4	Material i pisët”			

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke vlerësuar ndotjen dhe rrezikshmërinë që mbartin materialet spitalore, dhe rëndësinë e larjes së këtyre materialeve me cilësi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve, operatori ekonomik duhet të garantojë se për shërbimin e lavanderisë do të përdorë produkte cilësore, me certifikatë konformiteti ose cilësi CE. Një garanci e tillë pëmbushet me paraqitjen e skedave teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, shërben si siguri për AK mbi aftësinë e OE për zbatimin e kontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 (dy) mjete transporti, me qëllim transportin e materialit të butë, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Për të vërtetuar përbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- dokumentacion qe i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

Kriteri konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion të paktën një mjet, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e dy mjeteve lidhet ngushtësisht me procesin e transportimit të materialit të butë, nga lavanderia në ambientet e Spitalit dhe anasjelltas, pjesë e pandashme e realizimit të shërbimit të lavanderisë dhe përmbushjes së kërkesave në kohë të AK. Kjo kërkesë është vlerësuar e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e procesit, garantuar funksionimin e pandërprerë të shërbimit, mundëson organizim të marrjes së materialit të butë dhe shpërndarjes/dorëzimit të tij sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe termat e referencës. Numri 2 i mjeteve lidhet ngushtësisht edhe me faktin se shërbimi i lavanderisë do të ofrohet në 2 Njësitë e QSRSHN: Tiranë dhe Kavajë.

2.3.10 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entitetin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Duke iu referuar natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike dhe termave të referencës, dhe rrezikshmërinë që paraqesin materialet me ndotje spitalore, është e rëndësishme për AK të krijojë siguri që ofertuesi do të kryejë shërbimin e lavanderisë, duke garantuar shëndetin dhe sigurinë teknike në punë të punëmarrësve të angazhuar me kryerjen e këtij shërbimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Sikurse është paqsyruar në DST, në njoftimin e kontratës, Seksioni 2, pika 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ndalohet mbështetja për seksionin e kushteve të vecanta për kualifikim 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe “2.3 Kapaciteti teknik” pasi kapacitetet ekonomiko-financiare dhe teknike janë të domosdoshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe janë të lidhura ngushtësisht me

ofertuesin, pasi tregojnë kapacitete reale të tij. Shërbimi objekt prokurimi ka natyrë shërbimi periodik, në ambientet e Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, dhe rëndësi jetike për funksionimin e këtij spitali.

Karakterit specifik dhe i vazhdueshëm operacional, me një kohëzgjatje relativisht të gjatë prej 48 muajsh, kërkon kapacitete reale ekonomike, teknike, përvojë, infrastrukturë të dedikuar, logjistike të posaçme, siguri teknike të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e standarteve të cilësisë së kujdesit shëndetësor, ruajtjen e higjenes dhe mbrojtjen e shëndetit publik brenda ambienteve spitalore.

Këto kritere vlerësohen si karakteristika të vetë subjektit ofertues, të cilat tregojnë nëse ai është i aftë të përballojë detyrimet kontraktore, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura nga AK. Si rrjedhojë, ndalimi i mbështetjes në këto kritere garanton përgjegjësi të drejtëpërdrejtë, besueshmëri në ekzekutimin e kontratës/ave, si dhe vazhdueshmëri të shërbimit.

Gjithashtu, duke qene nje marreveshje kuader me afat 48 muaj, mbeshtetja ne kapacitetet e operatoreve ekonomike te tjere per elemente te realizimit ne nje periudhe kaq te gjate, do te krijonte pasiguri juridike.

Gjithashtu vlerësohet se kapacitetin ekonomik financiar duhet të disponohet nga ofertuesi, pasi shërbimi objekt prokurimi, duke qenë i natyrës kritike lidhur me higjenën spitalore dhe kontrollin e infeksioneve, duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme, pa ndërprerje dhe me reagim të menjëhershëm. Këto vecori kërkojnë kapacitet financiar të garantuara dhe të drejtëpërdrejtë, dhe jo kapacitetet të ndërmjetësuar. Treguesit financiarë (xhiro, bilance) nuk janë vetëm formalë, por dëshmi e aftësisë së ofertuesit për të përballuar shpenzimet operative ditore, furnizimet e vazhdueshme, mirëmbajtjen e pajisjeve, pagesën e personelit. Nëse këto kapacitete nuk sigurohen nga ofertuesi, ky i fundit nuk ka kontroll real mbi fondet, dhe rrjedhimisht as mbi proceset e tjera (personel, pajisje, furnizim) të cilat janë zinxhir me njëra tjetrën. Lejimi i mbështetjes në kapacitetet ekonomik-financiare mund të sjellë risk real në vazhdimësinë e shërbimit, konkretisht:

(Kriteri 2.2.1) Kriteri i xhiros vjetore është vendosur për të provuar ekzistencën e një kapaciteti ekonomik real, proporcional dhe funksional të operatorit ekonomik, në raport me kompleksitetin teknik dhe operacional të kontratës objekt prokurimi.

Objekti i procedurës konsiston në realizimin e shërbimit të lavanderisë spitalore, i cili përfshin trajtimin, larjen, dezinfektimin, paketimin dhe transportin e materialeve të buta spitalore, përfshirë materiale të kontaminuara, materiale me rrezik mikrobiologjik dhe materiale që kërkojnë trajtim të specializuar higjeno-sanitar .

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet disponimi i një strukture operative të qëndrueshme, e aftë të garantojë:

- funksionim të pandërprerë të procesit të lavanderisë;
- menaxhim të vazhdueshëm të ciklit të larjes dhe dezinfektimit;
- furnizim të rregullt me produkte higjieno-sanitare dhe detergjentë specifikë;
- mirëmbajtje të vazhdueshme të pajisjeve profesionale;
- administrim të vazhdueshëm të personelit dhe logjistikës;
- si dhe përballimin e flukseve operative të lidhura me funksionimin e një strukture spitalore.

Në këtë kuptim, xhiroja e kërkuar nuk përfaqëson vetëm tregues të volumit ekonomik, por element verifikues të faktit që operatori ekonomik disponon:

- aktivitet ekonomik real dhe të konsoliduar;
- kapacitet financiar të lidhur me ushtrimin efektiv të aktivitetit;
- aftësi për të përballuar në mënyrë të vazhdueshme kostot operative të kontratës.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në xhiron e një subjekti tjetër nuk garanton që operatori ekonomik ofertues vetë disponon kapacitetin ekonomik të nevojshëm për administrimin e drejtëpërdrejtë të kontratës. Në këto kushte:

- krijohet varësi ekonomike nga subjekt i tretë;
- mungon garancia për disponueshmërinë reale të kapaciteteve gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit;
- dhe rritet risku i mosgarantimit të vijueshmërisë operative të shërbimit.

Ky risk merr rëndësi të shtuar në një kontratë me karakter spitalor, ku mosrealizimi i vazhdueshëm i shërbimit cenon drejtpërdrejt funksionimin e strukturës shëndetësore, respektimin e protokolleve higjeno-sanitare dhe sigurinë e pacientëve.

Për rrjedhje, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kapaciteti ekonomik i kërkuar duhet të jetë atribut i vetë operatorit ekonomik që do të realizojë kontratën dhe nuk mund të konsiderohet i garantuar nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet ekonomike të subjekteve të tjera.

(Kriteri 2.2.2)

Kriteri mbi paraqitjen e bilanceve financiare dhe raportit pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit vendoset për të verifikuar qëndrueshmërinë financiare dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për të garantuar realizimin e kontratës në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit. Në dallim nga kriteri i xhiros, i cili lidhet me nivelin e aktivitetit ekonomik, bilanci financiar shërbejnë për të analizuar:

- strukturën financiare të operatorit ekonomik;
- nivelin e likuiditetit dhe aftësisë paguese;
- raportin ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve;
- ekspozimin financiar;
- si dhe aftësinë për të përballuar detyrime operative afatgjata.

Kjo analizë është thelbësore për një kontratë lavanderie spitalore, e cila kërkon:

- vazhdimësi të pandërprerë të shërbimit;
- funksionim të qëndrueshëm të pajisjeve profesionale;
- përballim të kostove operative dhe logjistike;
- reagim të menjëhershëm ndaj problematikave teknike;
- dhe garantim të standardeve higjeno-sanitare gjatë gjithë periudhës kontraktore.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në bilanci financiar të një subjekti tjetër nuk garanton që operatori ekonomik ofertues vetë ka stabilitetin financiar të nevojshëm për administrimin autonom të kontratës. Në këto kushte:

- mungon prova mbi aftësinë reale të operatorit për të përballuar në mënyrë të pavarur detyrimet kontraktore;
- krijohet varësi nga gjendja financiare e subjektit mbështetës;
- dhe rritet risku që operatori ekonomik të mos ketë kapacitet të mjaftueshëm për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.

Në një kontratë që lidhet me trajtimin e materialeve spitalore dhe kontrollin e riskut mikrobiologjik, çdo paqëndrueshmëri financiare e operatorit ekonomik mund të ndikojë drejtpërdrejt:

- në cilësinë e shërbimit;
- në respektimin e standardeve higjeno-sanitare;
- në vazhdimësinë e furnizimit të reparteve spitalore;
- si dhe në interesin publik që lidhet me sigurinë shëndetësore.

Për rrjedhje, Autoriteti Kontraktor vlerëson se stabiliteti financiar duhet të provohet nga vetë operatori ekonomik që do të realizojë kontratën dhe nuk mund të konsiderohet i garantuar nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet financiare të subjekteve të tjera.

Sa më sipër, realizimi i kontratës kërkon që operatori ekonomik të disponojë drejtpërdrejt: kapacitet likuiditeti, stabilitet financiar, aftësi për administrimin e kostove operative, si dhe kapacitet për garantimin e vijueshmërisë së shërbimit pa ndërprerje.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se përgjegjësia solidare garanton vetëm aspektin juridik të përgjegjësisë ndaj kontratës, por nuk garanton: disponueshmërinë reale të kapaciteteve ekonomike, administrimin efektiv të proceseve operative, dhe aftësinë financiare autonome të operatorit ekonomik që do të realizojë konkretisht shërbimin.

Lidhur me ndalimin e mbështetjes në kapacitetin teknik vlerësohet se: Shërbimi i lavanderisë në institucione spitalore ka karakter kritik dhe të pandërprerë, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me higjenën spitalore, kontrollin e infeksioneve, sigurinë e pacientëve. Ky nuk është një shërbim i zakonshëm që mund të delegohet pjesërisht. Në një shërbim të tillë procesi nuk përbëhet vetëm nga larja, por është një zinxhir i pandërprerë dhe i kontrolluar që përfshin grumbullim, larje, tharje, pastrim kimik, trajtim i materialeve të kontaminuara, hekurosje, paketim, transport, dorëzim, të cilat duhet të jenë nën kontrollin e plotë të operatorit ekonomik, në ambiente të certifikuar me personel të dedikuar. Ky zinxhir është i rëndësishëm që të sigurohet i pandërprerë dhe është shumë e rëndësishme të mos ndërpritet për të shmugur rrezikun e përzjerjes së kategorive të materiaeve, reduktimin e kohës së ekspozimit. Sigurimi i një zinxhiri të mbyllur përbën përpunim të menjëhershëm të materialeve, më pak risk në kontaminimin e materialeve, gjurmueshmëri në të gjitha proceset e shërbimit, pa vonesa dhe të sinkronizuar. Përfshirja e subjekteve të tjera në këto procese do të sillte fragmentim të zinxhirit operacional, rritje të ndërhyrjes mbi materialet dhe humbje të gjurmueshmërisë, duke rrezikuar përmbushjen e standarteve higjieno sanitare të kërkuara për një ambient spitalor.

(Kriteri 2.3.1)

Përvoja e ngjashme është tregues i aftësisë reale të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin, në të cilin kërkohet eksperiencë konkrete me materiale të kontaminuara, protokolle higjieno sanitare, organizim të zixhirit të mbyllur. Përvoja duhet të jetë në menaxhimin e të gjithë zinxhirit dhe jo vetëm në një proces.

Përvoja e kërkuar nuk lidhet me kryerjen e një aktiviteti të zakonshëm lavanderie apo pastrimi tekstilësh, por me administrimin e proceseve teknike të trajtimit të materialeve spitalore, përfshirë: administrimin e proceseve të lavanderisë spitalore, trajtimin e materialeve me ndotje spitalore, kontrollin e biokontaminimit, respektimin e protokolleve higjieno-sanitare, organizimin e flukseve të materialeve të pastra dhe të kontaminuara, garantimin e vazhdimësisë së furnizimit të reparteve spitalore, si dhe menaxhimin e riskut mikrobiologjik.

Për rrjedhje, përvoja e kërkuar përfaqëson: knoë-hoë operacional, ekspertizë specifike profesionale, kapacitet organizativ dhe Teknik, si dhe aftësi konkrete për administrimin e proceseve kritike higjieno-sanitare.

Nëse lejohet mbështetja në përvojën e një subjekti tjetër:

- nuk provohet që operatori ekonomik ofertues vetë zotëron eksperiencën dhe ekspertizën e nevojshme;
- mungon garancia që operatori ofertues ka administruar më parë procese lavanderie spitalore;
- mungon prova se operatori ofertues disponon realisht strukturat organizative dhe procedurat e nevojshme për kontrollin e riskut mikrobiologjik.

Në këto kushte, ekziston risk real që operatori ekonomik të përdorë përvojën e një subjekti tjetër vetëm për efekt kualifikimi formal, pa disponuar realisht kapacitetin profesional dhe organizativ të kërkuar për realizimin e kontratës. Ky risk është veçanërisht i lartë në një kontratë lavanderie spitalore, ku mungesa e eksperiencës reale mund të sjellë:

- cenim të protokolleve higjieno-sanitare;
- kontaminim të kryqëzuar;
- ndërprerje të furnizimit të reparteve;
- si dhe risk për sigurinë e pacientëve dhe personelit shëndetësor.

Për këtë arsye, vlerësohet se përvoja e ngjashme duhet të zotërohet nga vetë operatori ekonomik ose nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojë realisht shërbimin objekt prokurimi.

(Kriteri 2.3.2)

Disponimi i ambientit ku ushtrohet aktiviteti i lavanderisë përbën element thelbësor teknik dhe operacional për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Objekti i kontratës konsiston në trajtimin, larjen, dezinfektimin, paketimin dhe administrimin e materialeve të përdorura në ambiente spitalore, përfshirë materiale me ndotje spitalore dhe materiale me rrezik mikrobiologjik. Për këtë arsye, ambienti i lavanderisë nuk përbën thjesht aset fizik apo infrastrukturë ndihmëse, por përfaqëson komponent kritik të procesit teknik të realizimit të shërbimit.

Kriteri është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon realisht:

- ambient të përshtatshëm për realizimin e proceseve teknike të lavanderisë spitalore;
- organizim funksional të flukseve të materialeve të pastra dhe të kontaminuara;
- kushte higjeno-sanitare në përputhje me kërkesat e aktivitetit;
- si dhe kontroll të drejtpërdrejtë operacional mbi strukturën ku realizohet shërbimi.

Në këtë kuptim, akti higjeno-sanitar i kërkuar për ambientin lidhet drejtpërdrejt me kushtet konkrete të funksionimit të aktivitetit dhe me verifikimin e përputhshmërisë së ambientit me standardet higjeno-sanitare të nevojshme për trajtimin e materialeve spitalore .

Mbështetja në kapacitetet e një subjekti tjetër për këtë kriter:

- nuk garanton kontrollin e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik mbi ambientin ku realizohet shërbimi;
- nuk garanton disponueshmërinë reale dhe të vazhdueshme të ambientit gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës;
- si dhe krijon risk operacional dhe higjeno-sanitar në lidhje me administrimin e proceseve të lavanderisë spitalore.

(Kriteri 2.3.3)

Leja mjedisore Tipi B “Pastrim kimik” përbën autorizim administrativ dhe teknik të lidhur drejtpërdrejt me ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi dhe me ambientin konkret ku realizohet ky aktivitet.

Kjo leje kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik ushtron aktivitetin në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore që lidhen me trajtimin e proceseve të lavanderisë spitalore dhe përdorimin e produkteve kimike të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se ky kriter nuk përfaqëson kapacitet abstrakt teknik apo ekonomik, por provon: autorizimin ligjor për ushtrimin e aktivitetit, përputhshmërinë e aktivitetit me kërkesat mjedisore, si dhe kontrollin real të operatorit ekonomik mbi aktivitetin dhe ambientin ku realizohet shërbimi.

Mbështetja në lejen mjedisore të një subjekti tjetër:

- nuk garanton që operatori ekonomik ofertues vetë është i autorizuar për ushtrimin e aktivitetit;
- nuk garanton kontrollin real mbi proceset teknike që realizohen në ambientin përkatës;
- si dhe krijon pasiguri mbi përgjegjësinë administrative dhe operacionale gjatë realizimit të kontratës.

(Kriteri 2.3.4)

Certifikata SSH EN 14065:2016 mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit” përbën standard teknik të lidhur drejtpërdrejt me organizimin, administrimin dhe kontrollin e proceseve të lavanderisë spitalore.

Ky standard lidhet me: kontrollin e riskut mikrobiologjik, administrimin e proceseve të dezinfektimit, kontrollin e biokontaminimit gjatë trajtimit të tekstileve spitalore, si dhe garantimin e sigurisë higjeno-sanitare gjatë realizimit të shërbimit.

Kjo certifikatë nuk përfaqëson dokument formal të transferueshëm, por provon se:

- vetë operatori ekonomik disponon sistem funksional të kontrollit të biokontaminimit;
- procedurat operative të operatorit janë të certifikuara;
- ambientet, proceset dhe organizimi teknik i aktivitetit përmbushin standardet përkatëse.

Në rast se lejohet mbështetja në certifikimin e një subjekti tjetër:

- nuk provohet që sistemi i kontrollit të biokontaminimit zbatohet realisht nga operatori ofertues;
- mungon garancia mbi administrimin teknik të proceseve të dezinfektimit;
- si dhe krijohet risk mbi kontrollin higjeno-sanitar të shërbimit.

(Kriteri 2.3.5)

Personeli i kërkuar për realizimin e kontratës përbën komponent kritik të realizimit teknik dhe operacional të shërbimit të lavanderisë spitalore.

Për shkak të natyrës së shërbimit, personeli i kërkuar është i përfshirë drejtpërdrejt:

- në trajtimin e materialeve me ndotje spitalore;
- në administrimin e proceseve higjeno-sanitare;
- dhe në realizimin operacional të shërbimit në ambiente spitalore.

Mbështetja në personelin e një subjekti tjetër:

- nuk garanton disponueshmërinë reale dhe të vazhdueshme të stafit gjatë ekzekutimit të kontratës;
- nuk garanton kontrollin e drejtpërdrejtë organizativ dhe administrativ mbi personelin;
- si dhe krijon pasiguri mbi garantimin e vijueshmërisë operative të shërbimit.

(Kriteri 2.3.6)

Makineritë dhe pajisjet e kërkuara për realizimin e kontratës përbëjnë infrastrukturën teknike bazë për realizimin e proceseve të lavanderisë spitalore dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me kapacitetin real operacional të operatorit ekonomik.

Pajisjet e kërkuara, si janë elemente të domosdoshme për realizimin teknik të proceseve të trajtimit, dezinfektimit dhe administrimit të materialeve spitalore.

Në mënyrë të veçantë, kërkesa për barrierë larëse profesionale për materiale të kontaminuara lidhet drejtpërdrejt me kontrollin e biokontaminimit dhe ndarjen e flukseve të materialeve të pastra dhe të ndotura, elemente të cilat përbëjnë pjesë kritike të procesit të lavanderisë spitalore .

Mbështetja në pajisjet e një subjekti tjetër:

- nuk garanton disponueshmërinë reale dhe të vazhdueshme të pajisjeve gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës;
- nuk garanton kontrollin operacional mbi proceset teknike të lavanderisë;
- nuk garanton kapacitetin real të operatorit ekonomik për administrimin e flukseve operative të shërbimit;
- si dhe krijon risk operacional dhe higjeno-sanitar në lidhje me realizimin e proceseve të trajtimit të materialeve spitalore.

(Kriteri 2.3.7)

Kriteri 2.3.7 lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e standardeve teknike dhe cilësore të materialeve që do të përdoren në ambiente spitalore.

Këto elemente përbëjnë pjesë të organizimit teknik dhe metodologjik të operatorit ekonomik dhe nuk mund të konsiderohen të garantuara nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e një subjekti tjetër.

Në rast se lejohet mbështetja:

- mungon garancia mbi disponueshmërinë reale të materialeve dhe specifitimeve teknike të deklaruara;
- krijohet pasiguri mbi kontrollin e operatorit ekonomik mbi standardet cilësore të produkteve;
- si dhe rritet risku i mosgarantimit të përputhshmërisë teknike dhe higjeno-sanitare të materialeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës.

(Kriteri 2.3.8)

Kriteri mbi detergjentët dhe produktet larëse përbën element kritik të procesit teknik të lavanderisë spitalore dhe lidhet drejtpërdrejt me kontrollin higjeno-sanitar dhe proceset e dezinfektimit.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit Teknik, skedave teknike dhe katalogëve, certifikatave të konformitetit, si dhe autorizimeve për furnizim të rregullt të detergjentëve, është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik disponon produkte dhe metodologji të përshtatshme për trajtimin e:

- materialeve të kontaminuara;
- materialeve me rrezik mikrobiologjik;
- materialeve të përdorura në mjekësinë nukleare;
- dhe materialeve me ndotje spitalore .

Këto elemente lidhen drejtpërdrejt me: procesin teknik të dezinfektimit, kontrollin e biokontaminimit dhe garantimin e standardeve higjeno-sanitare gjatë realizimit të shërbimit.

Mbështetja në kapacitetet e një subjekti tjetër:

- nuk garanton kontrollin real të operatorit ekonomik mbi zinxhirin e furnizimit;
- nuk garanton disponueshmërinë e vazhdueshme të produkteve të deklaruara;
- si dhe krijon pasiguri mbi garantimin e standardeve teknike dhe higjeno-sanitare të procesit të lavanderisë.

(Kriteri 2.3.9)

Mjetet e transportit të kërkuara për realizimin e kontratës nuk përbëjnë mjete logjistike ndihmëse, por element kritik të procesit teknik dhe higjeno-sanitar të lavanderisë spitalore.

Objekti i kontratës përfshin transportin dhe administrimin e materialeve të buta spitalore, përfshirë:

- materiale të pastra, materiale të përdorura, materiale të kontaminuara dhe materiale me risk mikrobiologjik.

Në këtë kuptim, procesi i transportit përbën pjesë të integruar të zinxhirit operacional të kontrollit të biokontaminimit dhe kërkon:

- administrim të kontrolluar të flukseve të materialeve;
- shmangie të kontaminimit të kryqëzuar;
- garantim të kushteve higjeno-sanitare gjatë transportit;
- si dhe disponueshmëri të vazhdueshme të mjeteve gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Mbështetja në mjetet e transportit të një subjekti tjetër:

- nuk garanton kontrollin e drejtpërdrejtë operacional mbi procesin e transportit;
- nuk garanton disponueshmërinë reale dhe të vazhdueshme të mjeteve;
- nuk garanton administrimin korrekt të flukseve të materialeve të pastra dhe të kontaminuara;
- si dhe krijon risk operacional dhe higjeno-sanitar në lidhje me realizimin e proceseve të lavanderisë spitalore.

Në rastin konkret, transporti nuk përfaqëson proces ndihmës apo të shkëputur nga realizimi i kontratës, por pjesë integrale të procesit teknik të trajtimit të materialeve spitalore.

(Kriteri 2.3.10)

Kriteri mbi pajisjen e punonjësve me uniforma pune dhe pajisje mbrojtëse personale nuk përbën kërkesë formale administrative, por element të lidhur drejtpërdrejt me organizimin teknik, operacional dhe higjeno-sanitar të realizimit të shërbimit të lavanderisë spitalore.

Për shkak të natyrës së kontratës, personeli i angazhuar në realizimin e shërbimit do të jetë i përfshirë drejtpërdrejt:

- në trajtimin e materialeve të përdorura në ambiente spitalore;
- në administrimin e materialeve të kontaminuara dhe materialeve me risk mikrobiologjik;
- si dhe në proceset operative të transportit, trajtimit dhe dezinfektimit të materialeve spitalore.

Në këtë kuptim, uniformat e punës dhe pajisjet mbrojtëse personale përbëjnë pjesë integrale të sistemit të kontrollit higjeno-sanitar dhe të masave të sigurisë teknike gjatë realizimit të kontratës.

Mbështetja në kapacitetet e një subjekti tjetër për këtë kriter:

- nuk garanton kontrollin real të operatorit ekonomik mbi zbatimin efektiv të masave të sigurisë dhe higjienës;
- nuk garanton administrimin e drejtpërdrejtë të pajisjeve mbrojtëse dhe uniformave të personelit;
- si dhe krijon pasiguri mbi garantimin e standardeve të sigurisë teknike dhe higjeno-sanitare gjatë realizimit të kontratës.

Në rastin konkret, pajisja e personelit me uniforma pune dhe pajisje mbrojtëse personale përbën pjesë të organizimit të integruar teknik dhe operacional të shërbimit dhe nuk mund të konsiderohet e garantuar nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Sa më sipër, ndalimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera, sa i takon kapacitetit ekonomik-financiar dhe kapacitetit teknik është vlerësuar e tillë me qëllim shmangien e gabimeve në proceset e shërbimit të lavanderisë në institucion spitalor, të cilat nuk janë vetëm teknike, por ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin e pacientëve dhe personelit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Qendra Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi””, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacionin e përcjellë nga AK, rezulton si më poshtë:

Mbështetur në Urdhrin “Për krijimin e Komisionit për analizimin e kushteve dhe kostove të funksionimit të ambientderisë, hartimin e specifikimeve teknike dhe përgatitjen e argumentimeve përkatëse për realizimin e shërbimit të lavanderisë”, për procedurën me objekt: Për ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientet e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Tiranë dhe Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Kavajë:

Grupi filloi punën për argumentimin e nevojave, të llogaritjes së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike për këtë shërbim.

“Ky komision ka punuar mbi bazën e informacionit të siguruar nga performanca e shërbimit të lavanderisë dhe inventarit të butë, si dhe mbi zhvillimet në treg lidhur me ofrimin e këtij shërbimi.

Argumentimi i natyrës shumëvjeçare

Forma juridike që propozohet të lidhet ka natyrë të veçantë, pasi synon ofrimin e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Tiranë dhe Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Kavajë, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Ky shërbim kërkon:

- *Një investim fillestar të konsiderueshëm dhe me standarde të larta cilësie, si dhe investim të vazhdueshëm për sigurimin dhe qarkullimin e inventarit të butë në përdorim;*
- *Organizimin e plotë të procesit të grumbullimit të inventarit të butë të papastër, në përputhje me rregulloret për parandalimin e infeksioneve nozokomiale, transportimin në lavanderi, seleksionimin, larjen, hekurosjen, paketimin dhe rikthimin në pavione, duke garantuar që materiali i larë të mos ketë kontakt me materialin e palarë;*
- *Ofrimin e shërbimit 7 (shtatë) ditë në javë, nga ora 07:00 deri në orën 15:00, si dhe lënien në dispozicion të bazës materiale rezervë për nevojat e shtrimeve të reja, urgjencave apo situatave të tjera gjatë natës, sipas kërkesave të Kryeinfermierëve;*
- *Punësimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish të specializuar për realizimin e shërbimit;*
- *Monitorim të vazhdueshëm të kushteve dhe standardeve të zbatimit të kontratës.*

Duke pasur parasysh natyrën spitalore të institucionit, është thelbësore që materiali i butë të tërhiqet në kohë sa më të shkurtër nga pavionet dhe sallat e operimit, në përputhje me manualet e kujdesit spitalor dhe rregullat e higjienës (përfshirë selektimin sipas nivelit të ndotjes në thasë me ngjyra të dallueshme). Moslargimi në kohë i këtij materiali do të çonte në rritjen e infeksioneve spitalore, uljen e performancës së shërbimit ndaj pacientëve, rritjen e ditëqëndrimit dhe rritjen e përdorimit të medikamenteve, kryesisht antibiotikëve.

Volumi i materialit për t’u përpunuar e bën të domosdoshëm realizimin e investimeve të konsiderueshme në strukturën e lavanderisë, në organizimin e shërbimit në reparte dhe në burimet njerëzore.....

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet duhet të ofrojë një shërbim të integruar, i cili përfshin:

- *Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Tiranë dhe Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Kavajë, sipas grafikëve të përcaktuar, në përputhje me rregulloret, protokollat e higjienës dhe manualat e kujdesit spitalor;*
- *Larjen e materialit të butë në përputhje me standardet përkatëse higjiëno-sanitare;*
- *Hekurosjen dhe paketimin e materialit të butë;*
- *Shpërndarjen e materialit të larë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Kavajë, sipas grafikëve të miratuar;*
- *Shtrimin e shtratit të pacientit.*

Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës, nga dita e hënë deri ditën e diel.

Operatori ekonomik privat duhet të sigurojë inventarin e nevojshëm të materialit të butë për mbulimin e nevojave të pavioneve, përfshirë fundjavën, si dhe për shtrimin e shtrëtërve të pacientëve.

Gjithashtu, operatori duhet të garantojë:

- *Lënien në dispozicion të një baze materiale rezervë për nevoja të shërbimit gjatë shtrimeve të reja gjatë natës, rasteve urgjente, si dhe situatave të tjera të paparashikuara;*

- Zbatimin e grafikut të përcaktuar për ndërrimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse;
- Përmbushjen e kërkesave të Kryeinfermierëve të pavioneve në rastet kur ndërrimi i materialit të butë bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

Në kontratën e shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë duhet të parashikohen, ndër të tjera, këto elemente kryesore:

- I. Larja e materialeve të buta, në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe rregulloret për parandalimin e infeksioneve spitalore;
- II. Specifikimet teknike të materialit të butë (cilësia, përbërja, qëndrueshmëria, standardet e sigurisë, etj.);
- III. Etapat e menaxhimit të procesit të lavanderisë, nga grumbullimi i materialit të papastër deri në dorëzimin e materialit të larë dhe të paketuar në pavione.

Referuar të dhënave elektronike të dërguara nga shërbimi i statistikës me date 16.10.2025 protokolluar me nr.91/20 prot. datë 16.10.2025, shërbimi ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Njesia Tiranë ofrohet ne numrin prej 213 shtretër dhe ne numrin prej 86 shtretër ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Njesia Kavajë.

Ky vlerësim është marrë në konsideratë për të mundësuar një përlllogaritje të saktë dhe realiste të volumit të shërbimit që do të ofrohet në këto qendra spitalore.

Numri prej 243 shtretërsh përbën bazën mbi të cilën llogaritet aktiviteti spitalor, si dhe kapaciteti i hospitalizimit dhe ofrimit të shërbimit për pacientët.

Duke qenë se ky numër përfshin edhe shtretërit e shtuar gjatë periudhës së epidemisë së COVID-19 në spitalet COVID, grupi i punës parashikon që numri i përgjithshëm i shtretërve do të mbetet i pandryshuar edhe gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Gjithashtu në parashikim do të futen edhe 7 shtreterit e mjekeve te sherbimit roje 24 ore mbi 24 ore ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi” Njesia Tirane dhe 3 shtreterit e mjekeve te sherbimit roje 24 ore mbi 24 ore ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi” Njesia Kavaje, dhe mjekë roje i shtohet edhe mjeke te tjere specializante dhe që kanë shtratin e tyre për të cilët nevojitet vënia ne dispozicion e sherbimit te lavanderise.

Duke iu referuar strukturës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale numri i shtreterve per mjeket e sherbimit roje ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi”, Tirane dhe ne Qendrën Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi” Kavaje; do te ofroje sherbim ne total 13 shtreter.

Në këto kushte, analiza është kryer duke marrë parasysh numrin real të shtretërve.

Në rast të nevojave shtesë, për shkak të emergjencave, epidemiave në vend ose forcave madhore, numri i shtretërve mund të rritet. Për këtë arsye, duhet të sigurohet sasia e duhur e inventarit të materialit të butë, për t’u mbuluar këto raste.

... Materiali i butë që do të lahet nga operatori ekonomik grupohet në 2 (dy) kategori, në përputhje me Udhëzimin nr. 141, datë 08.03.2024, me Nr. 1334/1 prot., i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale, për përcaktimin e normativave të shërbimit të lavanderisë dhe standardizimin e uniformave të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër.

Gjithashtu, referuar Udhëzimit Nr. 141, datë 08.03.2024, me Nr. 1334/1 Prot., të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale, për “Përcaktimin e normativave të shërbimit të lavanderisë

dhe standardizimin e uniformave të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër” ,...

Tabelat dhe të gjitha të dhënat përkatëse të argumentuara sipas nevojave të Autoritetit përfitues janë pjesë e DST, në Specifikimet teknike dhe termat e referencës.

NJËSIA E PROKURIMIT